# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469692**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Skandal me fondet e investimeve në Turqi, 45 persona arrestohen nga 76 të hetuar |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/bota/skandal-me-fondet-e-investimeve-ne-turqi-45-persona-arrestohen-nga-76-te-hetuar/1027571/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 17:16:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 17:15:35 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fa3ef29e080389c9461ff313d5c3978bdbf5c95e434b001220e85682c63a1f5c` |
| TEKSTI | `0a8e73a0a52c0beed829111656e63a94b95f0ead190b27c26ef2f47ff1d003ef` |
| PAMJA | `dc7d1f9dd5a211e960625cc37deea9e85612b3b90c7f3c8c466664740f4cff4f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d84ceb16cb6983edea60cc8fa8f2bd52ed5d60c1e382bec662351a6a7f1e559a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d84ceb16cb6983edea60cc8fa8f2bd52ed5d60c1e382bec662351a6a7f1e559a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Skandal me fondet e investimeve në Turqi, 45 persona arrestohen nga 76 të hetuar



Autoritetet turke kanë arrestuar 45 persona në kuadër të një hetimi për një skandal që lidhet me fondet e investimeve. Lajmi u bë i ditur ndërsa ministri i Financave mohoi zërat se kishte dhënë dorëheqjen.

Ministri turk i Drejtësisë, Akin Gurlek, njoftoi në një postim në X se ndaj 76 të dyshuarve janë ndërmarrë procedura ligjore, ndërsa 45 prej tyre janë vënë në pranga.

Sipas tij, autoritetet kanë sekuestruar pasuritë e pronarëve të fondeve dhe të personave nën hetim që mbanin poste drejtuese. Ndërkohë, pasuritë e familjarëve të tyre të afërt janë ngrirë.

Mediat turke raportojnë se mes të arrestuarve ndodhet edhe Erkan Kilimci, ish-zëvendësguvernator i Bankës Qendrore.

Hetimi i prokurorëve lidhet me veprimtarinë e 131 fondeve të investimeve, në pronësi të shtatë kompanive. Sipas vlerësimeve të mediave turke, asetet e këtyre kompanive kapin një vlerë totale prej më shumë se 826 miliardë lirash turke, rreth 15 milionë euro.

Autoriteti Turk i Tregjeve të Kapitalit (SPK) i vendosi të gjitha këto kompani nën likuidim më 17 shtator. Sipas autoritetit, fondet administronin pasuritë e mbi 455,000 investitorëve privatë.

Ndërkohë, ministri i Financave Mehmet Simsek reagoi mbrëmjen e kaluar ndaj raportimeve për largimin e tij, duke i cilësuar ato "të pabaza".

"Spekulime të tilla, të cilat synojnë stabilitetin ekonomik të vendit tonë, nuk duhet të merren seriozisht", deklaroi Simsek në një postim në X.

Çështja nisi të marrë përmasa pasi SPK publikoi më 28 gusht udhëzime të reja, përmes të cilave fondet u kërkohej të mos përqendronin të gjitha investimet në një aksion të vetëm dhe të shpërndanin portofolet e tyre

të fundit/


Skandal me fondet e investimeve në Turqi, 45 persona arrestohe…


Balla kundër draftit të PD për ndarjen territoriale: Do të…


Cristian "Cuti" Romero emërohet kapiteni i ri i Argjentinës pas Lione…


Bajqinovci ironizon tarifën në Prishtinë: A do të paguajnë…


PDK-ja miraton deklaratën politike, kërkon ndryshime në…


Qarri: Aktgjykimi i Speciales lidhet me individë, ndërsa PDK…


Shqipëria konfirmon mungesën e Klisman Cakes në sfidën…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Për të zbatuar rregullat e reja, fondet nisën të shisnin aksione, ndërsa investitorët filluan të tërhiqnin paratë e tyre. Më pas, disa prej fondeve deklaruan se nuk mund t'i shndërronin asetet në likuiditet me shpejtësinë e nevojshme.

Hetimi përfshin akuza për krim të organizuar, mashtrim shtetëror, shkelje të legjislacionit për tregjet financiare dhe evazion fiskal.

Megjithatë, në rritje janë edhe pikëpyetjet mbi arsyet përse rregullatorët nuk ndërhynë më herët në këtë situatë.

Shtuar më 25.09.2026 19:15


Rast shqetësues në një shkollë në Itali: 6-vjeçarit i zbulohet në çantë thikë…


Shtëpia e Bardhë kufizon mbulimin mediatik të mbërritjes së Xi Jinping,…


Misteri i vdekjes së Geli Raubal: dokumentet e reja ngrenë dyshime për rolin …


Melania Trump flet për raportin me Barronin: Ai ndonjëherë preferon që u…



Rasti Emanuela Orlandi/ Gabriella Boggiani përfshihet në hetim pas…



Libri për Princeshë Dianën ndez përplasjen me Mbretin Charles, Pallati Mbretëror…



Trageti merr flakë pranë Mykonosit, evakuohen 29 persona; zjarri nisi nga nj…


Greqia tërheq profesionistët e larguar jashtë vendit, përmirësimi ekonomik nxi…

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.